

VENDIM
Nr. 411, datë 15.5.2013

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE, MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQËRISË “KURUM INTERNATIONAL” SHA, PËR PAGIMIN E RIMBURSIMIT TË TATIMIT MBI VLERËN E SHTUAR (TVSH)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 13 të ligjit nr. 8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ndryshuar, të nenit 8 të ligjit nr. 10 430, datë 9.6.2011 “Për krijimin e shoqërive “HEC Ulëz-Shkopet” sh.a., “HEC Tiranë, Lanabregas” sh.a. dhe “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a., dhe përcaktimin e formës e të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërive “HEC Ulëz-Shkopet” sh.a. dhe “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a., të kontratës për shitjen e të gjithë kapitalit të shoqërisë “HEC Ulëz-Shkopet” sh.a. (shtojca 7, pjesa 1, pika 14)”, ratifikuar me ligjin nr. 94/2013, datë 4.3.2013 “Për ratifikimin e kontratës për shitjen e 100 për qind të aksioneve të shoqërisë “HEC Ulëz-Shkopet” sh.a., të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “Kurum International” sh.a.”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë “Kurum International” sh.a., për pagimin e rimbursimit të tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH), sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe shoqëria “Kurum International” sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

PËR PAGIMIN E RIMBURSIMIT TË TATIMIT MBI VLERËN E SHTUAR (TVSH) NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE “KURUM INTERNATIONAL” SHA

10.5.2013

Kjo marrëveshje lidhet në Tiranë, Shqipëri, sot më 10.5.2013 ndërmjet:

Nga njëra anë: 1. Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministri, z. Ridvan Bode (në vijim MF); 2. Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministri z. Florjon Mima (në vijim METE); 3. Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm z. Gazmir Spahija (në vijim DPT);

dhe nga ana tjetër, “Kurum International” sh.a., një shoqëri aksionare, e themeluar dhe e cila vepron në përputhje me legjislacionin shqiptar, me seli në komunën Bradashesh, Kombinati Metalurgjik, Elbasan, Shqipëri, e regjistruar pranë Regjistrat Tregtar Shqiptar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit me numër unik identifikimi K02727230T, e përfaqësuar nga përfaqësuesi i saj ligjor z. Koray Zeytinoglu, mbajtës i kartës shqiptare të identitetit me numër 027808919;

Secila nga MF-ja, METE dhe DPT-ja do të quhen bashkërisht “autoritetet shtetërore” dhe secila nga MF-ja, METE, DPT-ja dhe “Kurum”-i do të quhen në vijim veçmas si pala dhe bashkërisht si palët.

Duke marrë në konsideratë se:

a) Në bazë të kërkesës së “Kurum”-it, organet tatimore shqiptare kanë kryer verifikimin për të konfirmuar TVSH-në e papaguar të rimbursueshme të “Kurum”-it. Shuma finale e TVSH-së së rimbursueshme të “Kurum”-it është konfirmuar në bazë të raport-kontrolleve: nr. 12775/10 prot., datë 2.12.2011, - nr. 89/9 prot.,

datë 4.4.2013, - nr. 11602/52 prot., datë 8.4.2013, - nr. 5005/4 prot., datë 16.4.2013, - nr. 8164/1 prot., datë 9.5.2013, dhe vendimit të Drejtorisë së Apelit Tatimor: 89/9 dhe 11602/52;

b) “Kurum”-i është shpallur ofertuesi fitues i procedurave të tenderimit për privatizimin e 100% të aksioneve të shoqërisë “HEC Ulëz-Shkopet” sh.a., e cila është një shoqëri aksionare e themeluar dhe që vepron në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, me seli në: Dibër Burrel, Ulëz-Burrel, Shqipëri, e regjistruar pranë Regjistrat Tregtar Shqiptar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit me numër unik identifikimi L183069010, e zotëruar tërësisht nga Republika e Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE);

c) Oferta e “Kurum”-it për privatizimin e 100% të aksioneve të “HEC Ulëz-Shkopet” sh.a. kërkonte se shumat që shteti shqiptar i detyrohet ofertuesit, në formën e rimbursimit të TVSH-së të verifikuar, të njihen nga autoriteti kontraktor (METE) dhe të përfshihen në negociatat kontraktore;

d) Në bazë të kësaj kërkesë, marrëveshja e shitblerjes së aksioneve, e lidhur ndërmjet “Kurum”-it dhe METE-s për shitblerjen e 100% të aksioneve të “HEC Ulëz-Shkopet” sh.a. (në vijim MSHA e Ulëz-Shkopet), përfshin, ndër të tjera, si kusht paraprak, lidhjen e një marrëveshjeje me shkrim mes Ministrisë së Financave të Shqipërisë (apo organeve të tjera kompetente tatimore) dhe blerësit (Kurum), për skedulimin e pagesës së shumave që shteti shqiptar i detyrohet blerësit, në formën e rimbursimit të tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH-së) të verifikuar sipas ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar;

e) Gjithashtu, përveç MSHA të Ulëz-Shkopet, “Kurum”-i dhe METE kanë lidhur një marrëveshje për shitblerjen e 100% të aksioneve të “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a. (në vijim MSHA e Bistricës), e cila nuk kushtëzohet nga rimbursimi i TVSH-së në favor të “Kurum”-it;

f) Gjatë realizimit të procesit të verifikimit të tepricës së TVSH-së të rimbursueshme për “Kurum”-in, “Kurum”-i kërkoj që autoritetet shtetërore të japin disa garanci për të siguruar rimbursimin efektiv të shumës finale të TVSH-së të rimbursueshme e të verifikuar dhe të konfirmuar nga DPT-ja;

g) Autoritetet shtetërore pranuam t’i ofrojnë “Kurum”-it disa garanci për të siguruar rimbursimin efektiv të shumës finale të verifikuar, të tepricës së TVSH-së së rimbursueshme, me kusht që “Kurum”-i të japë, përveç garancive kontraktore sipas MSHA-së të Ulëz-Shkopet, garanci shtesë që MSHA e Ulëz-Shkopet do të realizohet me sukses;

h) “Kurum”-i nënshkruan këtë marrëveshje në cilësinë e kreditorit të tepricës së TVSH-së, verifikuar nga DPT-ja si e rimbursueshme, sipas ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, pa cenuar të drejtat që i njihen “Kurum”-it për të apeluar sipas ligjit shqiptar, shumat e tepricës së TVSH-së, verifikuar nga DPT-ja si të rimbursueshme, dhe që përbën objekt të kësaj marrëveshjeje, si dhe në cilësinë e ofruesit të garancive shtesë në favor të METE-s, për realizimin e suksesshëm të MSHA-së të Ulëz-Shkopet;

i) DPT-ja nënshkruan këtë marrëveshje në cilësinë e organit tatimor kompetent për verifikimin dhe konfirmimin e tepricës së TVSH-së së rimbursueshme për “Kurum”-in, sipas ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar;

j) MF-ja nënshkruan këtë marrëveshje në cilësinë e autoritetit kompetent për të autorizuar pagesat nga Buxheti i Shtetit;

k) METE nënshkruan këtë marrëveshje në cilësinë e përfituesit të garancive shtesë nga “Kurum”-i, përveç atyre të dhëna sipas MSHA-së të Ulëz-Shkopet, për realizimin e suksesshëm të MSHA-së të Ulëz-Shkopet.

Rrjedhimisht, për të lehtësuar realizimin e MSHA-së të Ulëz-Shkopet, palët lidhin këtë marrëveshje sipas parashikimeve vijuese:

1. OBJEKTI I MARRËVESHJES

1.1 Objekti i kësaj marrëveshjeje është parashikimi i pagesës së shumave që “Kurum”-i ka të drejtë të marrë nga shteti shqiptar në formën e rimbursimit të gjendjes së tepricës kreditore të tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH-së), të verifikuar sipas ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, pa cenuar të drejtat që i njihen “Kurum”-it për të apeluar sipas ligjit shqiptar, shumat e tepricës së TVSH-së verifikuar nga DPT-ja si të rimbursueshme, dhe që përbën objekt të kësaj marrëveshjeje.

1.2 Objekti i kësaj marrëveshjeje përfshin edhe disa procedura në lidhje me instrumentet e garancisë, të rëna dakord mes palëve, sipas të cilave “Kurum”-i garantohet që shuma e tepricës së TVSH-së, verifikuar nga DPT-ja si e rimbursueshme do të paguhet efektivisht në kohë, dhe METE garantohet se “Kurum”-i do të realizojë me sukses MSHA-në e Ulëz-Shkopet.

2. HYRJJA NË FUQI

2.1 Kjo marrëveshje do të miratohet nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe do të hyjë në fuqi menjëherë me marrjen nga “Kurum”-i të njoftimit të shkruar të këtij miratimi nga çdonjëri nga autoritetet shtetërore.

3. PROCEDURAT E PAGESËS

3.1 DPT-ja dhe “Kurum”-i konfirmojnë vetëm për qëllimet e kësaj marrëveshjeje, se shuma finale e tepricës së TVSH-së, konfirmuar dhe verifikuar nga DPT-ja si e rimbursueshme në favor të “Kurum”-it, në bazë të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, është 3,473,337,091 lekë (tre miliardë e katërqind e shtatëdhjetë e tre milionë e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë e një lekë), pa cenuar të drejtat që i njihen “Kurum”-it për të apeluar sipas ligjit shqiptar, shumat e tepricës së TVSH-së verifikuar nga DPT-ja si të rimbursueshme, dhe që përbën objekt të kësaj marrëveshjeje.

3.2 MF-ja merr përsipër që brenda 1 (një) dite pune (që do të thotë çdo ditë e javës, përveç ditës së shtunë e të diel dhe ditët e festave zyrtare në Republikën e Shqipërisë, që nuk bien në një ditë të shtunë e të diele) nga data e hyrjes në fuqi, do të depozitojë dhe do të ngrijë në një llogari të posaçme garancie, hapur pranë “Raiffeisen Bank Albania”, një shumë të barabartë me vlerën e TVSH-së së rimbursueshme, të verifikuar e konfirmuar si më sipër, prej 3,473,337,091 lekësh (tre miliardë e katërqind e shtatëdhjetë e tre milionë e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë e një lekësh) (shuma e TVSH-së). MF-ja do të japë instruksione të parevokueshme që “Raiffeisen Bank Albania” të paguajë në favor të “Kurum”-it shumën e TVSH-së si më sipër, në përputhje me kushtet dhe afatet e bashkëlidhura si aneksi 1. MF-ja do të instruktojë “Raiffeisen Bank Albania”, që kjo e fundit të lëshojë një konfirmim që ka marrë këto instruksione nga MF-ja për pagesën e shumës së garantuar në lekë si më sipër, konfirmimi, i cili do të jetë kryesisht sipas tekstit të bashkëlidhur si aneksi 2 (deklarata për Kurum-in).

3.3 “Kurum”-i merr përsipër që brenda 1 (një) dite pune (që do të thotë çdo ditë e javës, përveç ditës së shtunë e të diel dhe ditët e festave zyrtare në Republikën e Shqipërisë, që nuk bien në një ditë të shtunë e të diele) nga data e hyrjes në fuqi, do të depozitojë dhe do të bllokojë në një llogari të posaçme garancie, hapur pranë “Raiffeisen Bank Albania”, një shumë prej 32,843,671 eurosh (tridhjetë e dy milionë e tetëqind e dyzet e tri mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një eurosh), e cila është e barabartë me vlerën e çmimit të shitblerjes së MSHA-së Ulëz-Shkopet (57.5 euro pesëdhjetë e shtatë pikë pesë milionë) – minus kundërvlerën në euro, sipas kursit ditor të Bankës së Shqipërisë, të shumës së TVSH-së si më sipër në nenin 3.2 (shuma e garancisë). “Kurum”-i do të japë udhëzime të parevokueshme që “Raiffeisen Bank Albania” të paguajë në favor të METE-s shumën e garancisë si më sipër në euro, në përputhje me kushtet dhe afatet e bashkëngjitura si aneksi 3. “Kurum”-i do të instruktojë “Raiffeisen Bank Albania” që kjo e fundit të lëshojë një konfirmim që ka marrë këto instruksione nga “Kurum”-i për pagesën e shumës së garantuar në euro si më sipër, konfirmimi, i cili do të jetë kryesisht sipas tekstit të bashkëlidhur si aneksi 4 (Deklarata për METE-n).

3.4 Brenda 1 (një) dite pune (që do të thotë çdo ditë e javës, përveç ditës së shtunë e të diel dhe ditët e festave zyrtare në Republikën e Shqipërisë, që nuk bien në një ditë të shtunë e të diele) nga data e hyrjes në fuqi, METE, “Kurum”-i dhe MF-ja do të takohen dhe do të shkëmbejnë konfirmimin për “Kurum”-in dhe konfirmimin për METE-n, lëshuar nga “Raiffeisen Bank Albania”, përkatësisht për “Kurum”-in dhe MF-në sipas neneve 3.2 dhe 3.3 më sipër.

4. TË PËRGJITHSHME

4.1 E gjithë marrëveshja

Ky dokument përbën marrëveshjen e plotë ndërmjet palëve në lidhje me objektin e mësipërm, dhe zëvendësojnë çdo marrëveshje apo mirëkuptim tjetër midis të njëjtave palë, të arritura me gojë apo me shkrim në lidhje me të njëjtin objekt.

4.2 Ndryshimet

Kjo marrëveshje dhe as ndonjë prej parashikimeve të saj, nuk mund të shfuqizohet apo të ndryshohet, nëse nuk shfuqizimi apo ndryshimi nuk kryhet nëpërmjet një marrëveshjeje tjetër të lidhur mes palëve me shkrim.

Termat e përcaktuar në MSHA-në e Ulëz-Shkopet do të përdoren në këtë marrëveshje me të njëjtin kuptim. Palët pranojnë se asgjë në këtë marrëveshje, përfshi anekset e saj, nuk përbën dhe nuk do të konsiderohet si një ndryshim apo amendim i çfarëdolloji, i asnjërit prej kushteve dhe afateve për realizimin e MSHA-së të Ulëz-Shkopet dhe/ose të MSHA-së të Bistricës.

4.3 Gjuha

Kjo marrëveshje lidhet dhe zbatohet në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe. Në rast mospërputhjes

mes versioneve në gjuhë të ndryshme, versioni në gjuhën shqipe mbizotëron ndaj atij në gjuhën angleze.

4.4 Njoftimet

a) Të gjitha njoftimet dhe çdo komunikim tjetër i çfarëdolloj (duke përfshirë, por pa u kufizuar te miratimet, marrëveshjet, kërkesat apo pyetjet), që njëra palë i drejton palës tjetër kryelënë lidhje me këtë marrëveshje, do të bëhen me shkrim dhe do të dërgohen me postë rekomande apo do të dorëzohen personalisht ose do të dërgohen me faks, te pala marrëse si vijon:

Për MF-në:

Ministrit të Financave

Ministria e Financave, bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1

Tiranë, Shqipëri

Fax: +355 (0) _____

Për METE-n:

Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”

Tiranë, Shqipëri

Fax: +355 (0) _____

Për DPT-në:

Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve

Rr. “Gjin Bue Shpata”, Tiranë, Shqipëri

Fax: +355 (0) _____

Për “Kurum”-in:

Administratorit të “Kurum International” sh.a.

Adresa: Komuna Bradashesh, Kombinati Metalurgjik, Elbasan, Shqipëri

Fax: +35554257844 ose +35542290522

b) Secila prej palëve, me një njoftim të shkruar, mund të ndryshojë adresat, si dhe personin në vëmendjen e të cilit këto njoftime apo komunikime do të dërgohen.

c) Çdo njoftim apo komunikim tjetër, i dërguar nga cilado prej palëve ndaj palës tjetër, që:

i) është dërguar me postë rekomande te marrësi në adresën e përcaktuar, do të prezumohet se është marrë nga marrësi ditën e shtatë pas datës së postimit të saj; ose

ii) është dorëzuar personalisht te marrësi gjatë orarit normal të punës së marrësit në adresën e tij të përcaktuar, do të prezumohet si e marrë nga marrësi në datën e dorëzimit; ose

iii) është transmetuar me faks te marrësi gjatë orarit të tij normal të punës te numri i faksit të përcaktuar, do të prezumohet si i marrë nga marrësi në datën e transmetimit, siç tregohet në raportin e dërgimit të faksit.

4.5 Ligji i zbatueshëm

Kjo marrëveshje do të qeveriset nga dhe do të interpretohet në përputhje me dispozitat e ligjit shqiptar.

4.6 Juridiksioni

Nëse do të lindë ndonjë mosmarrëveshje mes palëve në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshjeje, e cila nuk mund të zgjidhet mes tyre me mirëkuptim, atëherë mosmarrëveshja do të zgjidhet me arbitrazh sipas nenit 20.2 të MSHA-së Ulëz-Shkopet.

4.7 Kopjet

Kjo marrëveshje lidhet në 4 (katër) kopje, një për secilën palë në gjuhën angleze, dhe secila kopje do të jetë origjinale. Kjo marrëveshje do të përkthehet në shqip.

Në prani të njëra-tjetrës, palët lidhin këtë marrëveshje nëpërmjet nënshkrimit të saj nga përfaqësuesit e tyre të autorizuar.

Për Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë _____

[Z. Ridvan Bode]

[Ministër i Financave]

Për Ministrinë e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës

Për “Kurum International” sh.a. _____

[emri]

[pozicioni]

të Republikës së Shqipërisë _____
[Z. Florjon Mima]
[Ministër i Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës]
Për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve
të Republikës së Shqipërisë _____
[Z. Gazmir Spahija]
[Drejtore e Përgjithshme të Tatimeve]

SHTOJCA 1 INSTRUKSIONET BANKARE TË MF-së

Në vëmendje të: “Raiffeisen Bank Albania”

Lënda: Instruksione bankare për llogari garancie – me përfitues “Kurum International” sh.a.

Të nderuar zonja/zotërinj,

I/e nënshkruari/a, me tagra të plotë dhe i/e autorizuar për të vepruar në emër dhe për llogari të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet kësaj shkrese instruktoj në mënyrë të “Raiffeisen Bank Albania”, që të mbajë deri në datën 20.5.2013, deri në mbylljen e ditës shumën prej 3,473,337,091 lekësh (tre miliardë e katërqind e shtatëdhjetë e tre milionë e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë e një lekësh), depozituar prej nesh në bankën tuaj në llogarinë xxxxx, dhe të mos e përdorni këtë shumë për asnjë qëllim, përveçse në përputhje me instruksionet vijuese të pagesës.

Nëse deri në datën 20.5.2013 në mbyllje të orarit të punës, në orën 5:00 pm, ju “Raiffeisen Bank Albania” keni marrë nga “Kurum International” sh.a., një kopje të njësuar nga noteri, të deklaratës së përfundimit, nënshkruar mes “Kurum International” sh.a. dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë, që konfirmon se transaksioni për shitblerjen e 100% të aksioneve të “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a. është realizuar, atëherë Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë instrukton në mënyrë të përvokueshme “Raiffeisen Bank Albania” të paguajë në favor të “Kurum International” sh.a., jo më vonë se brenda një dite pune nga marrja e këtij dokumenti, në llogarinë e caktuar nga përfituesi, pa qenë të nevojshme formalitete të tjera nga ana jonë Ministria e Financave, shumën prej 3,473,337,091 lekësh (tre miliardë e katërqind e shtatëdhjetë e tre milionë e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë e një lekësh) (shuma e TVSH-së), me përshkrimin rimbursim TVSH-je, pa zbritje apo mbajte të shumave për qëllime të kostove bankare, të cilat do të paguheshin nga ne Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë.

Nëse deri në datën 20.5.2013 në mbyllje të orarit të punës, në orën 5:00 pm, ju “Raiffeisen Bank Albania” nuk keni marrë një kopje të njësuar nga noteri, të deklaratës së përfundimit si më sipër, atëherë totali i shumës së TVSH-së prej 3,473,337,091 lekësh (tre miliardë e katërqind e shtatëdhjetë e tre milionë e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë e një lekësh), depozituar prej nesh në llogarinë xxxxx do të çlirohet në favor të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë në llogarinë e njoftuar prej nesh jo më vonë se brenda një dite pune nga përfundimi i afatit të mësipërm.

Gjithashtu, nëse përpara ose në datën 20.5.2013, ju “Raiffeisen Bank Albania” merrni nga ne Ministria e Financave:

1. një konfirmim të shkruar se shuma totale 3,473,337,091 lekë (tre miliardë e katërqind e shtatëdhjetë e tre milionë e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë e një lekë) i është rimbursuar efektivisht “Kurum International” sh.a. si rimbursim TVSH-je; dhe

2. një kopje të SWIFT-it bankar që konfirmon kryerjen efektive të kësaj pagese në favor të “Kurum International” sh.a.

Atëherë totali i shumës së TVSH-së prej 3,473,337,091 lekësh (tre miliardë e katërqind e shtatëdhjetë e tre milionë e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë e një lekësh), depozituar prej nesh në llogarinë xxxxx, do të çlirohet, gjithashtu, në favor të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë në llogarinë e njoftuar prej nesh jo më vonë se brenda një dite pune nga marrja e konfirmimit dhe dokumenteve si më sipër.

Ju lutemi që të na lëshoni një konfirmim për “Kurum”-in, sipas tekstit bashkëngjitur, në 1 (një) kopje origjinale. Nëse ne Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë i kthejmë “Raiffeisen Bank Albania” këtë kopje origjinale të konfirmimit për “Kurum”-in, brenda 3 (tri) ditësh pune nga data e lëshimit të konfirmimit, atëherë totali i shumës së TVSH-së prej 3,473,337,091 lekësh (tre miliardë e katërqind e shtatëdhjetë e tre milionë e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë e një lekësh), depozituar prej nesh në Bankën tuaj në

llogarinë xxxxx, do të çlirohet, gjithashtu, në favor të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë në llogarinë e njoftuar prej nesh, jo më vonë se brenda një dite pune.

Për mënjanimin e çdo dyshimi, këto instruksione pagese mund të ndryshohen ekskluzivisht me nënshkrimin e përbashkët të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe të “Kurum International” sh.a.

Përsëritet,

Ministria e Financave të Republikës së Shqipërisë

Vendi [.....], data [.....]

SHTOJCA 2 KONFIRMIMI PËR KURUM-in

Në vëmendje të: Kurum International sh.a.

Lënda: Konfirmim bankar për instruksione pagese me përfitues – “Kurum International” sh.a.

Të nderuar zonja/zotërinj,

Ne “Raiffeisen Bank Albania”, ju konfirmojmë se Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë ka depozituar në bankën tonë shumën 3,473,337,091 lekë (tre miliardë e katërqind e shtatëdhjetë e tre milionë e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë e një lekë), dhe se ne “Raiffeisen Bank Albania” kemi marrë instruksionet vijuese të parevokueshme nga ana e Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë.

Nëse deri në datën 20.5.2013 në mbyllje të orarit të punës, në orën 5:00 pm, ne “Raiffeisen Bank Albania” kemi marrë nga “Kurum International” sh.a., një kopje të njësuar nga noteri, të deklaratës së përfundimit, nënshkruar mes “Kurum International” sh.a. dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë, që konfirmon se transaksioni për shitblerjen e 100% të aksioneve të “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a. është realizuar, atëherë ne “Raiffeisen Bank Albania” do të paguajmë në favor të “Kurum International” sh.a., jo më vonë se brenda një dite pune nga marrja e këtij dokumenti, në llogarinë e caktuar nga ju, pa qenë të nevojshme formalitete të tjera nga ana jonë Ministria e Financave, shumën prej 3,473,337,091 lekësh (tre miliardë e katërqind e shtatëdhjetë e tre milionë e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë e një lekësh) (shuma e TVSH-së), me përshkrimin rimbursim TVSH-je, pa zbritje apo mbajte të shumave për qëllime të kostove bankare, të cilat do të paguhet nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë.

Nëse deri në datën 20.5.2013 në mbyllje të orarit të punës, në orën 5:00 pm, ne “Raiffeisen Bank Albania” nuk keni marrë një kopje të njësuar nga noteri të deklaratës së përfundimit si më sipër, atëherë totali i shumës së TVSH-së prej 3,473,337,091 lekësh (tre miliardë e katërqind e shtatëdhjetë e tre milionë e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë e një lekësh), depozituar prej Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë në llogarinë xxxxx, do të çlirohet në favor të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë në llogarinë e njoftuar prej tyre, jo më vonë se brenda një dite pune nga përfundimi i afatit të mësipërm.

Gjithashtu, nëse përpara ose në datën 20.5.2013, ne “Raiffeisen Bank Albania” marrim nga Ministria e Financave:

1. një konfirmim të shkruar se shuma totale 3,473,337,091 lekë (tre miliardë e katërqind e shtatëdhjetë e tre milionë e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë e një lekë) i është rimbursuar efektivisht “Kurum International” sh.a. si rimbursim TVSH-je; dhe

2. një kopje të SWIFT-it bankar që konfirmon kryerjen efektive të kësaj pagese në favor të “Kurum International” sh.a.

Atëherë totali i shumës së TVSH-së prej 3,473,337,091 lekësh (tre miliardë e katërqind e shtatëdhjetë e tre milionë e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë e një lekësh), depozituar prej Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë në llogarinë xxxxx, do të çlirohet, gjithashtu, në favor të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë në llogarinë e njoftuar prej tyre jo më vonë se brenda një dite pune nga marrja e konfirmimit dhe dokumenteve si më sipër.

Ky konfirmim lëshohet në 1 (një) kopje origjinale. Nëse ne “Raiffeisen Bank Albania” marrim nga

Ministria e Financave të Republikës së Shqipërisë këtë kopje origjinale të konfirmimit për “Kurum”-in, brenda 3 (tri) ditësh pune nga data e lëshimit të konfirmimit, atëherë totali i shumës së TVSH-së prej 3,473,337,091 lekësh (tre miliardë e katërqind e shtatëdhjetë e tre milionë e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë e një lekësh), depozituar prej Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë në bankën tonë në llogarinë xxxxx do të çlirohet gjithashtu në favor të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë në llogarinë e njoftuar prej tyre jo më vonë se brenda një dite pune.

Për mënjanimin e çdo dyshimi, këto instruksione pagese mund të ndryshohen ekskluzivisht me nënshkrimin e përbashkët të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe të “Kurum International” sh.a.

Përsëritje,

“Raiffeisen Bank Albania”

Vendi [.....], data [.....]

SHTOJCA 3 INSTRUKSIONET BANKARE TË KURUM-IT

Në vëmendje të: “Raiffeisen Bank Albania”

Lënda: Instruksione bankare për llogari garancie – me përfitues Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë

Të nderuar zonja/zotërinj,

I/e nënshkruari/a, me tagra të plotë dhe i/e autorizuar për të vepruar në emër dhe për llogari të “Kurum International” sh.a., nëpërmjet kësaj shkrese instruktoj në mënyrë të “Raiffeisen Bank Albania”, që të mbajë shumën 32,843,671 euro (tridhjetë e dy milionë e tetëqind e dyzet e tri mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një euro) depozituar prej nesh në bankën tuaj në llogarinë xxxxx (llogaria e “Kurum”-it) deri në datën 24.5.2013, deri në mbylljen e orarit të veprimeve bankare, ora 02:30 pm dhe të mos e përdorni këtë shumë për asnjë qëllim, përveçse në përputhje me instruksionet vijuese të pagesës.

“Kurum International” sh.a. jep instruksione të përvokueshme që “Raiffeisen Bank Albania” të paguajë automatikisht, jo më vonë se një ditë bankare nga përfundimi i afatit të mësipërm, në favor të Ministrisë së Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë, në llogarinë e caktuar prej tyre, dhe pa qenë të nevojshme formalitete të tjera nga ana jonë “Kurum International” sh.a., shumën prej 32,843,671 euro (tridhjetë e dy milionë e tetëqind e dyzetë e tri mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një euro) (“shuma e garancisë”), pa zbritje apo mbajte të shumave për qëllime të kostove bankare, të cilat do të paguhen nga ne “Kurum International” sh.a., nëse deri në datën 24.5.2013 deri në mbylljen e orarit të veprimeve bankare, ora 02:30 pm, ju “Raiffeisen Bank Albania” nuk merrni nga ne “Kurum International” sh.a.:

1. një shumë depozite shtesë në llogarinë e “Kurum”-it, për një vlerë prej 24,656,329 eurosh (njëzetë e katër milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e njëzet e nëntë eurosh) (depozita shtesë), e cila së bashku me shumën e garancisë ekzistuese, do të rrisë balancën totale të llogarisë së “Kurum”-it në shumën totale prej 57,500,000 eurosh (pesëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind mijë eurosh) (depozita totale); së bashku me:

2. një instruksion të përvokueshëm me shkrim nga “Kurum International”, për të transferuar menjëherë nga llogaria e “Kurum”-it, jo më vonë se brenda një dite pune, shumën e depozitës totale prej 57,500,000 eurosh (pesëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind mijë eurosh), në favor të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në llogarinë e caktuar prej tyre, me përshkrim pagesë e plotë e çmimit të shitblerjes për privatizimin e 100% të aksioneve të “HEC Ulëz-Shkopet” sh.a. (pavarësisht këtyre instruksioneve të “Kurum International”).

Nëse ju “Raiffeisen Bank Albania” nuk do të merrni nga ne, brenda datës 24.5.2013 deri në mbylljen e

orarit të veprimeve bankare, ora 02:30 pm, depozitën shtesë, së bashku me instruksionet e shkruara si më sipër, atëherë shuma e garancisë prej 32,843,671 eurosh (tridhjetë e dy milionë e tetëqind e dyzet e tri mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një eurosh) depozituar prej nesh në bankën tuaj në llogarinë xxxxx, do t'i paguhet menjëherë, jo më vonë se brenda një dite pune nga përfundimi i afatit 24.5.2013, në favor të Ministrisë së Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë në llogarinë e caktuar prej tyre, pa qenë të nevojshme formalitete të tjera nga ana jonë "Kurum International" sh.a., me përshkrimin kompensim për mosrealizimin e blerjes së aksioneve të "HEC Ulëz-Shkopet".

Ju lutemi që të na lëshoni një konfirmim për METE, sipas tekstit bashkëngjitur, në 1 (një) kopje origjinale. Nëse ne "Kurum International" sh.a. i kthejmë "Raiffeisen Bank Albania" këtë kopje origjinale të konfirmimit për METE-n, brenda 3 (tri) ditësh pune nga data e lëshimit të konfirmimit, atëherë totali i shumës së garancisë prej 32,843,671 eurosh (tridhjetë e dy milionë e tetëqind e dyzet e tri mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një euro), depozituar prej nesh në bankën tuaj në llogarinë xxxxx, do të çlirohet, gjithashtu, në favor të "Kurum International" sh.a. në llogarinë e njoftuar prej nesh, jo më vonë se brenda një dite pune.

Për mënyhësimin e çdo dyshimi, këto instruksione pagese mund të ndryshohen ekskluzivisht me nënshkrimin e përbashkët të Ministrisë së Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë dhe të "Kurum International" sh.a.

Përshëndetje,

"Kurum International" sh.a.

Vendi [.....], data [.....]

SHTOJCA 4 KONFIRMIMI PËR METE

Në vëmendje të: Ministrisë së Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë

Lënda: Konfirmim bankar për instruksione pagese me përfitues Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë

Të nderuar zonja/zotërinj,

Ne "Raiffeisen Bank Albania", ju konfirmojmë se "Kurum International" sh.a. ka depozituar në një llogari në bankën tonë (llogaria e "Kurum"-it), shumën 32,843,671 (tridhjetë e dy milionë e tetëqind e dyzet e tri mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një euro) dhe se ne "Raiffeisen Bank Albania" kemi marrë nga "Kurum International" sh.a. instruksionet vijuese të përvokueshme për të paguar automatikisht, në favor të Ministrisë së Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë, në llogarinë e caktuar prej jush, dhe pa qenë të nevojshme formalitete të tjera nga ana jonë "Kurum International" sh.a., shumën prej 32,843,671 eurosh (tridhjetë e dy milionë e tetëqind e dyzet e tri mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një eurosh) (shuma e garancisë), pa zbritje apo mbajte të shumave për qëllime të kostove bankare, të cilat do të paguheshin nga "Kurum International" sh.a., nëse deri në datën 24.5.2013 deri në mbylljen e orarit të veprimeve bankare, ora 02:30 pm, e "Raiffeisen Bank Albania" nuk marrim nga "Kurum International" sh.a.:

1. një shumë depozite shtesë në llogarinë e "Kurum"-it, për një vlerë prej 24,656,329 eurosh (njëzetë e katër milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e njëzet e nëntë euro) (depozita shtesë), e cila së bashku me shumën e garancisë ekzistuese, do të rrisë balancën totale të llogarisë së "Kurum"-it në shumën totale prej 57,500,000 eurosh (pesëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind mijë euro) (depozita totale); së bashku me:

2. një instruksion të përvokueshëm me shkrim nga "Kurum International", për të transferuar menjëherë nga llogaria e "Kurum"-it, jo më vonë se brenda një dite pune, shumën e depozitës totale prej 57,500,000 eurosh (pesëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind mijë eurosh), në favor të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në llogarinë e caktuar prej jush, me përshkrim pagesë e plotë e çmimit të shitblerjes për privatizimin e 100% të aksioneve të "HEC Ulëz-Shkopet" sh.a.

Nëse ne "Raiffeisen Bank Albania" nuk do të marrim nga "Kurum International" sh.a., brenda datës 24.5.2013 deri në mbylljen e orarit të veprimeve bankare, ora 02:30 pm, depozitën shtesë, së bashku me instruksionet e shkruara si më sipër, atëherë shuma e garancisë prej 32,843,671 eurosh (tridhjetë e dy milionë e tetëqind e dyzet e tri mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një eurosh) depozituar në llogarinë e "Kurum"-it, do të

paguhet nga ne banka, menjëherë, jo më vonë se brenda një dite pune nga përfundimi i afatit 24.5.2013, në favorin tuaj, Ministria e Ekonomisë e Republikës së Shqipërisë në llogarinë e caktuar prej jush, me përshkrimin kompensim për mosrealizimin e blerjes së aksioneve të “HEC Ulëz-Shkopet”, pa qenë të nevojshme formalitete të tjera nga ana e “Kurum International” sh.a.

Ky konfirmim lëshohet në 1 (një) kopje origjinale. Nëse ne “Raiffeisen Bank Albania” marrim nga “Kurum International” sh.a. këtë kopje origjinale të konfirmimit për METE-n, brenda 3 (tri) ditësh pune nga data e lëshimit të konfirmimit, atëherë totali i shumës së garantuar 32,843,671 euro (tridhjetë e dy milionë e tetëqind e dyzet e tri mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një euro), depozituar prej “Kurum International” sh.a. në llogarinë xxxxx do të çlirohet gjithashtu në favor të “Kurum International” sh.a. në llogarinë e njoftuar prej tyre, jo më vonë se brenda një dite pune.

Për mënjanimin e çdo dyshimi, këto instruksione pagese mund të ndryshohen ekskluzivisht me nënshkrimin e përbashkët të Ministrisë së Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë dhe të “Kurum International” sh.a.

Përsëndetje,

“Raiffeisen Bank Albania”

Vendi [.....], data [.....]